

VENDIM
Nr.164, datë 18.3.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË QYTETIT TË FUSHË-KRUJËS TË MJEDISEVE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, TË CILAT JANË NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e degës së mobilizimit në qytetin e Fushë-Krujës të cilat janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojnë në pronësi bashkisë së këtij qyteti, për ngritjen e qendrës së trajtimit të qytetarëve pa përkrahje e të vetmuar (azil) të këtij komuniteti.

2. Prona me numër rendor 806 “Dega e mobilizimit” në Fushë-Krujë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së qytetit të Fushë-Krujës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Fushë-Krujës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano